



Prishtinë, 12 tetor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_452_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 34 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. MODIFIKOHET Licenca për furnizim/tregti me energji elektrike** e dhënë ndërmarrjes “GEN-I Tirana Sh.p.k” – me numër licence ZRRE/Li_34/09.
- II. Licenca e modifikuar (tani e tutje “Licencë për import dhe eksport të energjisë elektrike”** me numër licence **ZRRE/Li_34/12**, e ndërmarrjes “**GEN-I TIRANA” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË**) do të hyjë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi. Obligohet “**GEN-I TIRANA” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË** që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për import dhe eksport të energjisë elektrike të ndërmarrjes “GEN-I TIRANA” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 29.12.2009. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
- Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e treta. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të treta dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
- Duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë dhe mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar